

1. Jam pranuar Avokat në Gjykatën Supreme të Anglisë & Uellsit më 1992.
2. Më 2001 jam emëruar Udhëheqës i Zyrës të Komisionit të Pavarur Gjyqësor në Bosnje dhe Hercegovinë, përgjegjës për Republikën Serbe. Prej vitit 2003 deri më 2005, kam qenë anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Prokurorial në Bosnje dhe Hercegovinë. Në vitin 2004 jam emëruar gjyqtar i Gjykatës së Bosnjes dhe Hercegovinës. Mandati im gjyqësor në Bosnje ka përfunduar më 2008.
3. Më 2007 jam bërë Ekspert Civil i Dislokueshëm i Zyrës për punë të Jashtme & të Komonuelthit të MB dhe kam punuar në çështjet e lidhura me drejtësinë.
4. Me 28 prill 2008, jam caktuar nga Zyra për Punë të Jashtme & të Komonuelthit ("FCO") në Ekipin Planifikues të Bashkimit Evropian ("EUP") në Kosovë, i cili më vonë u bë EULEX. Kam shërbyer si gjyqtar penal në nivelin e Gjykatës së Qarkut. Në vitin 2014 jam emëruar kryetar i gjyqtarëve të EULEX-it.
5. Kam lënë EULEX-in më 2017 pas viktimizimit nga stafi i lartë i EEAS (Shërbimi i Veprimit të Jashtëm i Bashkimit Evropian).
6. EULEX-i dhe Shërbimi i Veprimit të Jashtëm Evropian vazhdojnë të pohojnë që bordi disiplinor për sjellje të keqe ka konstatuar që jam përgjegjës, që një gjykatë angleze i ka hedhur poshtë pohimet e mia për sjellje të këqija kundër EULEX-it dhe EEAS dhe që, për pasojë, dëshmia ime nuk mund të pranohet si e besueshme.
7. Është e saktë që kundër meje kishin nisur procedurat disiplinore. Po ashtu është e saktë që bordi disiplinor ka gjetur kundër meje.. Megjithatë, procesi disiplinor ishte farsë. Kishte filluar nga një staf i lartë i EEAS, të cilin e kisha akuzuar për sjellje të keqe të rëndë. Personat e njëjtë i kanë nisur hetimet disiplinore dhe i kanë përcjellur pretendimet në një bord disiplinor. Personat e njëjtë kanë bërë komplot me hetuesit dhe anëtarët e bordit disiplinor..
8. Që nga vitit 2013 unë kisha raportuar në instancat e Zyrës së MB për Punë të Jashtme & të Komonuelthit lidhur me sjelljen e keqe të stafit të EULEX-it, përfshirë kryerjen e veprave penale dhe ndërhyrjen e stafit të lartë menaxhues të EULEX-it në gjykimet penale. EULEX-i nuk filloi kurrfarë hetimesh.

9. Më 2016, një gjyqtar i një shteti anëtar të BE-së, i punësuar nga EULEX-i, i hakoi emailat e mi privatë. Kopjet e emailave të mi iu dhanë stafit të lartë të EEAS. Ata emaila zbuluan që isha sinjalizues dhe që kisha raportuar tek Qeveria e MB dhe agjencia kundër mashtrimit e BE-së (OLAF) lidhur me çështjet që ishin shqetësim serioz brenda Misionit të EULEX-it, përfshirë ndërhyrjen në gjykimet penale dhe kryerjen e veprave penale.
10. Tek pas zbulimit të emailave të mi privatë, Shërbimi Evropian për Veprim të Jashtëm i filloi procedurat disiplinore kundër meje. Qëllimi i procesit disiplinor ishte të më largonin. Prosesi ishte dizajnuar për t'u paraqitur si kredibil dhe legjitim. Megjithatë, siç do ta demonstroj, procesi ishte me të meta dhe i manipuluar nga EEAS me bashkëpunimin e heshtur të anëtarëve të bordeve disiplinore.
11. Personat përgjegjës për ato procedura disiplinore ishin personat që i kishin marrë emailat e mi privatë dhe personat që i kisha akuzuar për sjellje të këqija serioze. Hetuesit, përfshirë një ish-gjyqtar të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, po ashtu i posedonin emailat e mi privatë. Ky është “ish-gjyqtari” i famshëm “i Gjykatës Evropiane të Drejtësisë”, të cili i referohen shpesh EULEX-i dhe BE-ja në mënyrë që t'i japin procesit të tyre të komplotuar disiplinor një shenjë të kredibilitetit.
12. Unë kërkoja hetim të pavarur lidhur me hakimin e emailave të mi privatë. EEAS e refuzoi kërkesën. Në vend të kësaj, hetimin e kreu EULEX-i. Kur ngula këmbë që të intervistohet ish-gjyqtari i Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, i cili po hetonte lidhur me pretendimet kundër meje, EULEX-i më njoftoi që hetimi lidhur me hakimin e emailave të mi ishte “mbyllur”. Nuk më dhanë kurrfarë sqarimi. Kërkoja ta shoh dosjen e hetimit për të parë çfarë hapash kishin ndërmarrë hetuesit dhe cilët dëshmitarë ishin intervistuar. Më në fund më dhanë qasje në dosjen e hetimit. Kur e hapa dosjen, në të gjendej vetëm një dokument dhe ai ishte njoftimi për mua me të cilin informohej ai që hetimi ishte mbyllur.
13. Komandanti i mëparshëm i Operacioneve Civile, Kenneth Deane, njeri nga anëtarët me të lartë të stafit të SHJVE të UE, i cili ka raportuar para Perfaqesueses së Lartë, Federica Mogherini, në përgjigje me shkrim dërguar avokateve të mij. Tim ka mohuar që i kishte marrë kopjet e emailave të mij të hakuar, Mohimin e përsëriti edhe zëvendësi i tij, Bert Versmessen, gjithashtu në përgjigje me shkrim avokateve të mij.
14. Përkundër “kërkesave të shumta” të UK FCO, EEAS nuk filloi ndonjë hetim të pavarur lidhur me qasjen e paligjshme në emailat e mi privatë.

15. Është e qartë përse EEAS nuk ka dashur hetim lidhur me hakimin e emailave të mi privatë: ky ishte mision i BE-së për sundimin e ligjit qëllimi i të cilit ishte pikërisht promovimi i sundimit të ligjit dhe megjithatë, në mes të tij, një gjyqtar i një shteti anëtar të BE-së, i punësuar nga EULEX-i, iu kishte qasur në mënyrë të paligjshme emailave të një gjyqtari tjetër.
16. Pretendimet kundër meje ishin përcjellë nga njerëzit të cilët i pata akuzuar në bord disiplinor për sjellje të keqe të rëndë. Bordi përbëhej nga tre anëtarë. Vetëm një anëtar i bordit ishte gjyqtar. Dy të tjerët ishin një jurist që punonte në sistemin e BE-së dhe një zyrtar për logjistikë i punësuar nga EEAS, i cili ishte vartës i personave të cilët i kisha akuzuar për sjellje të keqe të rëndë!
17. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut e ka bërë shumë të qartë në vendimet e saj që në procedurën gjyqësore kundër gjyqtarëve, pjesa dërrmuese e anëtarëve të bordit duhet të jenë gjyqtarë. Në rastin tim vetëm një anëtar ishte gjyqtar.
18. Ky nuk ishte keqpërdorimi i vetëm i procesit disiplinor. Bordi nuk i ka marrë parasysh provat shfajësuese. Avokatët e mi ia kanë dhënë bordit tri deklarata të dëshmitarëve shumë të rëndësishëm dhe shfajësues. Dy prej atyre deklaratave ishin nga ish-gjyqtarë të lartë. Ato deklarata u injoruan nga bordi. Në të vërtetë, bordi madje as nuk iu është referuar atyre dëshmitarëve në vendimin e tij.
19. Unë, po ashtu, nuk kam qenë i pranishëm kur janë marrë në pyetje dëshmitarët e tjerë të rëndësishëm. Në vend të kësaj, bordi më ka dërguar diçka së cilës Bordi iu ka referuar si “rezyme” e provave të tyre. Unë nuk kam pasur mundësi t’i kundërshtojë provat e tyre ose t’i bëjë pyetjet e mia.
20. Procesi disiplinor ishte mashtrim i përcaktuar nga EEAS që t’u ofrojë atyre bazë për largimin tim. Kurrë nuk ka pasur për qëllim ta gjejë të vërtetën.
21. Unë dorëzova një ankesë të cilën e shqyrtoi një bord i ankesave i përbërë nga tre gjyqtarë të BE-së. Ankesa u shqyrtua në maj 2019.
22. Bordi i ankesave nuk e mori parasysh substancën e pretendimeve të bëra kundër meje. Vendimi i bordit të ankesave u mbush me pasaktësi faktike dhe arriti përfundime të pambështetura në

fakte apo ligj. Megjithatë, më shqetësuesi ishte konstatimi i bordit të ankesave lidhur me çështjet që kishin të bënin me procesin disiplinor dhe, në veçanti, me përbërjen e bordit disiplinor.

Edhe pse ligjërishit dhe nga aspekti strukturor kishte të meta, vendimi i bordit të ankesave i mbështet përfundimet në vijim:

(a) nuk kishte ndonjë kusht që bordi disiplinor që e shqyrtonte një ankesë kundër një gjyqtari duhet të përbëhej nga një shumicë e gjyqtarëve dhe

(b) ishte jorelevante që një anëtar i bordit ishte një i punësuar në departamentin që e kishte filluar procedurën disiplinore dhe (i) ishte vartës i personit që e kishte filluar procedurën disiplinore dhe (ii) vartës i personit të cilin subjekti i procedurës disiplinore e kishte akuzuar për sjellje të keqe.

23. Duke konstatuar në këtë mënyrë, bordi i ankesave thjesht i ka injoruar aktgjyimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Konventat dhe Kartat Ndërkombëtare.

24. Bordi i Ankesave po ashtu e ka injoruar nenin 6 të GJEDNJ i cili thotë që unë kam pasur të drejtë të gjykoem “...nga një tribunal i pavarur dhe i paanshëm i krijuar me ligj.” Një anëtar i bordit ishte i punësuar në EEAS, në departamentin që e kishte filluar procedurën disiplinore kundër meje dhe ishte vartës i një personi të cilin e pata akuzuar për sjellje të keqe të rëndë. Ky nuk ishte një tribunal i paanshëm dhe qëllimi nuk kishte qene kurre qe të ishte tribunal i paanshëm.

25. Prandaj, jo vetëm që shumica e anëtarëve të bordit në këtë rast nuk kanë qenë gjyqtarë, në kundërshtim të qartë me të drejtën dhe praktikën ndërkombëtare, por bordi po ashtu nuk ishte i paanshëm. Kjo ishte shkelje fundamentale e nenit 6 të GJEDNJ – njërit prej parimeve thelbësore të drejtësisë të cilin BE-ja shtret që po e promovon.

26. Shkurt, bordi i ankesave e ka shkelur të drejtën ndërkombëtare. Në procedurën disiplinore të ndërmarrë kundër meje ishin të përfshirë katër gjyqtarë të sistemit të BE-së: një në panelin disiplinor të shkallës së parë dhe tre në panelin e apelit. A nuk ishin në dijeni këta katër gjyqtarë të BE-së për vendimet e rëndësishme të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut që trajtonin çështje të cilat përfshinin përbërjen e bordeve disiplinore ku përfshiheshin

gjqtarët? A nuk kishin dijeni këta katër gjyqtarë të BE-së për shumë konventa ndërkombëtare që parashikojnë që në procedurat disiplinore kundër gjyqtarëve së paku një shumicë e bordit disiplinor duhet të jenë gjyqtarë? A nuk kanë dëgjuar këta katër gjyqtarë të BE-së për nenin 6 të GJEDNJ që garanton të drejtën e të pandehurit për seancë dëgjimore të drejtë para një tribunali të paanshëm? A nuk ishin këta katër gjyqtarë të BE-së në dijeni për parimet më themelore të drejtësisë dhe të procesit të rregullt? A ishin katër gjyqtarët e BE-së, të cilët e shqyrtuan ankesën time, thjesht të paaftë apo ishin palë në komplotin për ta shtrembëruar rrjedhën e drejtësisë?

27. Kryerja e procedurave disiplinore që janë ndërmarrë kundër meje e zbulon shkallën deri në të cilën EEAS është e përgatitur për ta manipuluar një proces dhe për ta shtrembëruar rrjedhën e drejtësisë, në mënyrë që ta arrijnë rezultatin e dëshirua.

28. Jam i sigurtë ti bëni pyetje vetes tuaj se pse keto mund të janë relevante hetimin tuaj.

Kjo është relevante sepse demonstroi se UE nuk i respekton të drejtat e të pandehurit për gjykim të drejtë siq parashihet në Nenin 6 të KEDN (ECHR). Kjo është gjithashtu relevante sepse demonstroi në mënyrë me të mirë të mundshme që UE është i gatshëm të manipulojë me procese ligjore për të arritur objektivat e saj. Është relevante sepse demonstroi në mënyrë se si UE është i përgatitur të manipulojë me përberjen e trupave gjyqësore për të siguruar se mund të kontrollojë rezultatin. Është relevante sepse vërteton që UE ka respekt të ulët për sundim të ligjit procedural apo substancial. Është relevante sepse vërteton që gjyqtarët brenda sistemit të UE janë të gatshëm të shktremberojnë kursin e drejtësisë për të shërbyer qëllimeve të shëfave të tyre dhe është relevante sepse tregon që Shtetet Anëtare të UE janë të gatshëm të pranojnë abuzimet e rënda të drejtësisë dhe sundimit të ligjit vetëm për të ruajtur integritetin e UE dhe institucioneve të saj.

29. Kjo nuk ishte hera e parë që një pjesëtar i lartë i EEAS ishte përpjekur ta manipulonte një hetim disiplinor. Pretendohet se një gjë e ngjashme ndodhi gjatë një hetimi për stafin e lartë të misionit EUPOL COPPS. Ishte pretenduar që ishte përfshirë ish-Komandanti i Operacioneve Civile – personi i njëjtë i cili kishte nisur hetimet kundër meje. Në të vërtetë, po ashtu pretendohet që ish-Komandanti i Operacioneve Civile ishte përpjekur ta asgjësonte të ashtuquajturin hetim ‘Fantazmë’ lidhur me sjelljen e pretenduar të keqe në EULEX. Në një email, një pjesëtar i lartë i stafit të shërbimit të jashtëm të një shteti anëtar

të BE-së i referohet kësaj si përpjekje për ta asgjësuar atë hetim dhe e përshkruan ish-Komandantin e Operacioneve Civile si “telashe”.

30. Edhe pse i kisha raportuar EULEX-it dhe UK FCO për sjellje të keqe të rëndë në të cilin përfshihej stafi i lartë i EULEX-it dhe EEAS prej vitit 2013, asnjëra prej këtyre ankesave nuk i ishte nënshtruar një hetimi të pavarur.
31. EULEX-i dhe EEAS vazhdojnë të pohojnë që nuk kam bashkëpunuar me hetuesit që e kryenin një hetim të pavarur lidhur me pretendimet e mia për sjellje të keqe në EULEX. Kjo është gënjeshtër. Personat e emëruar nga EEAS për ta udhëhequr hetimin lidhur me pretendimet e mia për sjellje të keqe ishin personat e njëjtë që i pata akuzuar për sjellje të keqe të rëndë. Këta ishin personat e njëjtë – përfshirë ish-Gjyqtarin e Gjykatës Evropiane – të cilët i posedonin emailat e mi privatë dhe të cilët kishin komplotuar për ta manipuluar procesin disiplinor kundër meje. Ky nuk do të ishte kurrë hetim ‘i pavarur’ për pretendimet e mia – dhe kurrë nuk kishte qëllim që të ishte hetim i pavarur. Ajo që duhet të jetë e qartë deri më tani është që BE-ja do ta manipulojë procesin për ta arritur rezultatin e dëshiruar. Kjo u bë e qartë gjatë mandatit tim si kryetar i gjyqtarëve të EULEX-it.
32. Disa herë i kam shkruar Përfaqësueses së Lartë, Federica Mogherini, ambasadorëve të BE-së në Bruksel dhe UK FCO. I informova ata që hetimet kundër meje ishin farsë dhe që hetimi lidhur me pretendimet e mia për sjellje të keqe të rëndë nuk ishte i pavarur dhe transparent. Nuk mora përgjigje nga ambasadorët e BE-së. Federica Mogherini i injoroi shqetësimet e mia.
33. Përfaqësuesja e Lartë e BE-së dhe ambasadorët e PSC të BE-së i mbyllën sytë ndaj keqpërdorimeve të qarta të cilat ndodhnin në Kosovë, duke e zgjedhur dobinë politike mbi drejtësinë dhe sundimin e ligjit. Shkeljet e mëdha të drejtësisë dhe të sundimit të ligjit mund të injorohen për aq gjatë sa ruhet integriteti i BE-së dhe i institucioneve të saj.
34. Është e saktë që Tribunali i Punës në Angli e hodhi poshtë një rast të cilin e ngrita unë kundër EULEX-it dhe EEAS. Tribunali **nuk** ka konstatuar që pretendimet e mia nuk ishin të vërteta. Tribunali **nuk** e ka shqyrtuar substancën e pretendimeve të mia. Tribunali e hodhi poshtë rastin tim vetëm për arsye se konstatoi që nuk kishte juridiksion për t’i shqyrtuar ato pretendime. Kjo ishte arsyeja e vetme. Në të vërtetë, avokati i cili u paraqit për EULEX-in

dhe EEAS para tribunalit kurrë nuk pohoi që pretendimet e mia nuk ishin me vlerë ose që meritonin të shqyrtoheshin në gjykatë. Kundërshtimi i tyre i vetëm ishte që gjykata duhet të jetë në Bruksel dhe jo në Londër. Pohimi i EULEX-it që tribunalali i kishte hedhur poshtë pretendimet e mia ishte keqinformues – dhe EULEX-i kishte për qëllim keqinformimin.

35. Dukshëm, EULEX-i dhe EEAS kurrë nuk i kanë mohuar pohimet e mia për korrupsionin. Në vend të kësaj, ata janë përgjigjur duke më sulmuar personalisht. Tani është koha që EULEX dhe SHEVJ te adresojë keto qeshtje dhe te përgjigjet pyetjeve.

36. Pasi që iu njoftova me historikun, më lejoni t'iu informojë lidhur me ngjarjet që mund të jenë relevante për hetimint tuaj.

37. Më 2014 aplikova për pozitën e kryetarit të gjyqtarëve të EULEX-it. Më pas u intervistova nga një panel i gjyqtarëve ndërkombëtarë dhe i stafit të lartë të BE-së në Bruksel dhe në Prishtinë. Në tetor 2014, u emërova kryetar i gjyqtarëve të EULEX-it dhe gjyqtar i Gjykatës Supreme të Kosovës. Qëndrova në atë pozitë deri në nëntor 2017 kur dhashë dorëheqje duke kërkuar 'shkarkim konstruktiv' për shkak të mënyrës diskriminuese me të cilën isha trajtuar.

[REDACTED]

[REDACTED]

[REDACTED]

[REDACTED]

[REDACTED]

[REDACTED]

[REDACTED]

40. Kur u emërova kryetar u takova me Komandantin e Operacioneve Civile, Kenneth Deane, në Zyrën e Shefit të Misionit të EULEX-it në Prishtinë. Ai ma bëri shumë të qartë që misioni kishte për qëllim t'i largonte nga jeta politike disa persona, të cilët ai i përshkruajti si “peshqi të mëdhenj”. Ai tha: *“Pres t'i shoh gjyqtarët e EULEX-it duke i dënuar personat e akuzuar nga misioni.”* Sipas fjalëve të tij, nga gjyqtarët e EULEX-it, *“pritej ta kryenin pjesën e tyre”* në sigurimin e suksesit të misionit. Për mua ishte e qartë që “suksesi” do të matej me numrin e dënimeve.

41. Ekzistonin po ashtu objektiva të qarta politike të misionit. Për komunitetin ndërkombëtar prioritet u bënë marrëdhëniet me Serbinë dhe shtyerja përpara e dialogut Prishtinë-Beograd. Ata që pengonin procesin shiheshin si obstrukcionistas që duhej të largoheshin nga pozitat me pushtet dhe ndikim. Gjyqtarët e EULEX-it ishin mjete për ta arritur këtë. Ajo që nuk mund të arrihej me anë të dialogut politik, do të arrihej përmes procesit të shtrembëruar gjyqësor. Këtu përfshiheshin personat e tërë spektrit politik, përfshirë jo vetëm ish-komandantën e UÇK-së por edhe politikanët e popullarizuar.

42. Albin Kurti ishte person me rëndësi politike për komunitetin ndërkombëtar. Së pari e kam dëgjuar emrin e tij kur kam ardhur në Kosovë më 2008. Më kujtohet qartë furia brenda EULEX-it në vitin 2010 për ta përzgjedhur panelin e gjyqtarëve të EULEX-it që do ta dënonte Albin Kurtin. Atë rast e kishte nisur UNMIK-u. Kur e mori përsipër rastin EULEX-i, udhëheqja e misionit ishte e vendosur ta largonte atë nga jeta politike. Së fundi, pas incidenteve me gaz lotsjellës në parlament, EULEX-i ishte i vendosur që duhet të ngriheshin akuza kundër tij. Isha i pranishëm gjatë një takimi me udhëheqjes e lartë të EULEX-it dhe të prokurorëve të EULEX-it kur u diskutua çështja e fillimit të procedurës penale kundër Albin Kurtit. Udhëheqja e lartë e EULEX-it insistonte që rastin ta merrnin gjyqtarët e EULEX-it. Unë refuzova sepse veprat penale nuk ishin në mandatin e EULEX-

it. Prokurorët e EULEX-it pastaj u udhëzuan të bashkëpunonin me prokurorët lokalë për ta siguruar ngritjen e akuzave penale kundër tij dhe të tjerëve.

43. Në rolin tim si kryetar i gjyqtarëve të EULEX-it unë kam marrë pjesë në shumë takime të udhëheqjes së lartë. Zakonisht pikat kryesore të agjendës ishin çështjet politike. Rrallë janë diskutuar çështjet që kishin të bënin me drejtësinë pa iu referuar pak politikës ose politikanëve.

44. Një mënyrë me anë të së cilën komuniteti ndërkombëtar do të ishte në gjendje ta fitonte mbështetjen e Serbisë ishte krijimi i Dhomave të Specializuara të Kosovës. Serbia nuk kishte besim në gjyqësorin vendas se do t'i dënonte shqiptarët e Kosovës, të cilët pretendoheshin se ishin fajtorë për krime të luftës. DHSK ishte mekanizmi i vetëm për t'u angazhuar me Serbinë dhe për ta avancuar dialogun ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit.

45. Para caktimit tim si Kryetar të Gjyqtarëve të EULEX-it unë kam pasur dijeni për diskutimet brenda EULEX-it në lidhje me transferimin e dosjeve tek autoritetet prokuroriale të Serbisë. Këtu janë përfshirë dosjet e EULEX-it të marra nga UNMIK. Unë gjithashtu kam qenë në dijeni për bisedimet e vazhdueshme ndërmjet prokurorëve të EULEX-it dhe prokurorëve të Serbisë. Në të vërtetë prokurorët e EULEX-it kanë udhëtuar në Serbi në shumë raste për të diskutuar lëndet me prokurorët e Serbisë.

Kur u bërë kryetar i gjyqtarëve të EULEX-it më 2014, zbulova që me dhjetëra dosje të krimeve të luftës u ishin dorëzuar autoriteteve prokuroriale në Serbi. Kishte hetime lidhur me mizoritë e pretenduara të kryera nga personat e përkatësisë etnike serbe gjatë konfliktit. Ato dosje përmbanin jo vetëm hollësitë për veprat e pretenduara penale dhe kryesit e tyre, por përfshinin edhe të dhënat personale të qytetarëve të Kosovës të cilët ishin viktimat të këtyre krimeve dhe hollësi të dëshmitarëve, shumica prej të cilëve ishin të përkatësisë etnike shqiptarë të Kosovës. Këto ishin vepra të kryera në Kosovë kundër qytetarëve të Kosovës nga persona të etnicitetit serb, shumica prej të cilëve ishin po ashtu shtetas të Kosovës. Kërkoja nga udhëheqja e lartë e EULEX-it ta sqaronin bazën ligjore për transferimin e këtyre dosjeve dhe e kërkoja një listë të rasteve që ishin dorëzuar. Kërkesa ime u refuzua.

46. Kjo ishte krejtësisht e pavend dhe, pa diskutim e paligjshme, që këto dosje, lidhur me veprat e kryera në Kosovë, të dorëzoheshin tek autoritetet prokuroriale në një juridiksion të huaj.

47. Kur e diskutova këtë çështje me udhëheqjen e lartë të EULEX-it, u bë e qartë që ata e dinin që autoritet serbe nuk kishin burime – ose, në të vërtetë, gatishmëri – t'i hetonin këto krime. Më tej, ata e dinin që, në realitet, nuk kishte të ngjarë që këto raste do të hetoheshin ndonjëherë – pavarësisht nga fakti çfarë burimesh ishin në dispozicion. Ashtu siç e kuptoj këtë unë, autoritetet serbe nuk e kanë ndjekur penalisht asnjërin prej rasteve të dorëzuara nga EULEX-i.
48. Mos ekzistimi i një marrëveshjeje ekstradimi ndërmjet Kosovës dhe Serbisë ishte bërë problem. Ishte e qartë që BE dëshironte t'i shmangej një konfrontimi të vështirë me Serbinë lidhur me ekstradimin e të pandehurve të etniciteti serb, në kohën kur përpiqej t'i normalizonte marrëdhëniet ndërmjet Serbisë dhe Kosovës. Dukej që zgjidhja ishte thjesht që autoritetet serbe të merreshin me ato raste – diçka që dihej se ata nuk kishin kapacitet as qëllim ta bënin.
49. Më 2013, para se të emërohesha kryetar i gjyqtarëve të EULEX-it, isha kryetar i trupit gjykues në rastin e njohur si 'Kleçka'. Ky ishte një rast i krimeve të luftës me dhjetë të pandehur, pjesë e të cilëve ishte një politikan i spikatur, Fatmir Limaj. Kleçka. Ishte një rast me rëndësi për misionin. Pretendimet përfshinin torturimin dhe vrasjen e të burgosurve serbë të luftës dhe të civilëve shqiptarë. Nga takimet e udhëheqjes së lartë të EULEX-it në të cilat kisha marrë pjesë, ishte e qartë që ndjekja penale e këtij rasti ishte me rëndësi për angazhimin e vazhdueshëm të Serbisë në dialogun Beograd-Prishtinë.
50. Kleçka ishte rast i profilit të lartë në të cilin misioni kishte investuar shumë energji dhe një shumë të konsiderueshme të parave. Misioni ishte i vendosur ta dënonte Fatmir Limajn dhe, çka është më me rëndësi, ta largonte nga jeta politike. Misioni duhej ta bindte Serbinë që nuk i përfaqësonte thjesht vetëm interesat e shqiptarëve të Kosovës. Gjykimi i parë përfundoi kur trupi gjykues, i udhëhequr nga një gjyqtar i Gjykatës së Kurorës të MB, konstatoi që nuk kishte prova të mjaftueshme kundër të akuzuarve.
51. Gerrit Sprenger, zëvendëskryetar i gjyqtarëve të EULEX-it nuk humbi kohë për ta shprehur pakënaqësinë e tij lidhur me shfaqësimet në Kleçka dhe faktin që, sipas fjalëve të tij, “shtetet anëtare prisnin dënime”. Udhëheqja e misionit më ka thënë më shumë se një herë që po të mos e rrisnim numrin e dënimeve, shtetet anëtare nuk do të kishin mundësi ta arsyetonin shpenzimin e madh dhe të gjithë do ta humbnim punën. Në të vërtetë, auditimet e misionit gjithmonë përqendroheshin në numrin e dënimeve.

52. Kleçka shkoi në apel dhe Gerrit Sprenger e emëroi veten kryetar të trupit gjykues të apelit. Trupi gjykues i apelit i ktheu prapa gjetjet e gjyqtarëve që e kishin gjykuar rastin dhe e dërgoi rastin në rigjykim.

53. Rëndësia politike e këtij rasti për misionin mu theksua përsëri në një email me 29 janar 2013 nga kryetari i atëhershëm i asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it, Charles Smith, në të cilin më kërkoi që ta fus në listë rastin sa më shpejt që të jetë e mundur për atë që ai e përshkruajti si “...një numër të arsyeve, *shumica prej tyre politike*”. Nëse EULEX-i është mision për sundimin e ligjit, përse përpiqet ta çojë përpara rastin për “arsye politike”? Cilat ishin ato “arsye politike”?

54. Kur u caktova në trup gjykues, më 2013 Charles Smith më informoi që misioni “varej shumë” nga rezultati i këtij rasti. Ai tha që misioni “priste dënime.” Madje ai tha që puna ime mund të rrezikohej nëse të pandehurit nuk dënoheshin. Gjyqtari Charles Smith tani është gjyqtar në Dhomat e Specializuara të Kosovës.

Unë ia raportova atë bisedë me Charles Smith ambasadës së MB në Kosovë në një email me 11 korrik 2013, të cilin ia drejtova Joe Preston. Pastaj u takova me Joe Preston për të diskutuar lidhur me takimin me gjyqtarin Smith. Ia bëra shumë të qartë z. Preston që kjo ishte ndërhyrje e qartë në pavarësinë e gjyqësorit dhe përpjekje për të ndërhyrë në rezultatin e një gjykimi penal. Ne diskutuam për ndërhyrjen në emërimin e trupave gjykues. Ia bëra të qartë që prisja që MB të intervenonte në emrin tim në Bruksel për të siguruar që gjyqtarët nuk do të viheshin hapurazi nën presion politik. Ai më tha që nuk duhej të shqetësohesha nga kërcënimet e tilla. Ai më tha që qëndrimi im në mision mund të dëmtohej nëse shihesha si “ngatërrestar”.

56. Kleçka nuk ishte rasti i vetëm kur Charles Smith kishte bërë përpjekje të ndërhynte në rezultatin e rastit. Unë e ndaja zyrën me një gjyqtare tjetër të EULEX-it. Me 18 korrik 2013 kolegja ime gjyqtare e EULEX-it mori një email nga Charles Smith, në të cilin ai e udhëzonte atë lidhur me mënyrën si të vazhdojë në një rast penal të profilit të lartë, në të cilin rast ajo ishte kryesuese. Isha po ashtu i pranishëm me 11 dhe 15 korrik 2013 kur ajo

pranoi thirrje telefonike nga Charles Smith, të cilat i lëshoi në altoparlant, gjatë të cilave Charles Smith u përpoq të ndërhyjë në rastin e njëjtë duke sugjeruar që ajo ta shqiptonte një dënim me burgim. Unë i përmenda këto biseda në një email të menjëhershëm që ia dërgova asaj.

57. Gjyqtari [REDAKTUAR] po ashtu pretendoi përmes emailave se Charles Smith dhe zëvendësi i tij, Gerrit Sprenger, ishin përpjekur të ndërhyjnë në njërin prej rasteve të tij. Në të vërtetë, ai pohoi që procedurat e mëvonshme disiplinore të filluara kundër tij ishin rezultat i refuzimit të tij për t'i respektuar udhëzimet e tyre në atë rast të caktuar.

58. Unë isha kryesues i bordit disiplinor në procedurat të cilat më pastaj filluan kundër gjyqtarit [REDAKTUAR]. Ky trup gjykues i refuzoi pretendimet. Mëngjesin e shqyrtimit të trupit gjykues, unë mora një thirrje telefonike nga shefi i misionit EULEX, Bernd Borchardt, i cili u përpoq të më udhëzonte lidhur me vendimin që duhej ta mirrte trupi gjykues.

59. Edhe pse gjyqtari [REDAKTUAR] ishte shpallur i pafajshëm për sjellje të keqe nga bordi disiplinor, Charles Smith nuk pranoi t'ia lejonte atij vazhdimin e kryerjes së funksioneve të tij gjyqësore. Udhëheqja e misionit mendonte që atij nuk mund t'i besohet më që do ta kryejë atë që pritet prej tij. Në vend të kësaj, gjyqtari [REDAKTUAR] u dërgua në Zyrën e Udhëheqësit të Ekzekutivit ku shërbeu si zyrtar i lavdëruar ligjor. Kur Charles Smith u largua përfundimisht, gjyqtari Pardal e rifillioi funksionin gjyqësor.

60. Sa i përket udhëheqjes së misionit, njëri prej shqetësimeve kryesore të ngritura shumë herë ishte fakti që zyrtarët policorë – të kaluarit dhe ata aktualë – ishin në pozita të larta në kuadër të strukturës komanduese të EULEX-it, përfshirë Kenneth Deane, Komandantin e Operacioneve Civile (ne vete nje titiull interesant per nje person qe udheheq nje mision te sundimit te ligjit) dhe Bernd Thran, Zëvendësshefin e Misionit EULEX. Kjo ngriti një mori çështjesh. Së pari, zyrtarët policorë dukej që besonin që kushdo që akuzohej për një vepër ishte automatikisht fajtor. Së dyti, zyrtarët policorë ishin të përgatitur që pa diskutim ta respektonin çdo udhëzim të cilin ua jepnin padronët e tyre politikë në Bruksel. Së treti, ata prisnin nga stafi me pozita më të ulëta se ata me grada (përfshirë gjyqtarët) t'i zbatonin urdhërat. Kjo nuk ishte diçka të cilën nuk e kishte vërejtur FCO. Në të vërtetë, ambasadori në detyrë i MB në Kosovë, Joe Preston e ngriti këtë çështje gjatë njërit prej takimeve tona.

61. Si kryetar i gjyqtarëve të EULEX-it, unë rregullisht kam marrë pjesë në takimet me shefin e misionit të EULEX-it. Misioni vazhdoi ta përcaktonte suksesin e misionit me numrin e

dënimeve të të pandehurve të profilit të lartë, të cilët ishin burgosur. Kishte raste të shumta kur gjyqtarët e EULEX-it nxirrnin vendime me të cilat nuk pajtohej shefi i misionit. Pas një vendimi të tillë, në takim me shefin e misionit ai me pyeti: “*A është gjyqtari me kontratë apo i caktuar nga shteti i vetë?*” Kjo nënkuptonte që nëse gjyqtari/gjyqtarja ishte me kontratë do të ishte më lehtë të hiqej qafe ai/ajo. Disa herë ai tha që gjyqtarët duhej të “*dërgobeshin në shtëpi?*” pas marrjes së vendimeve me të cilat ai nuk pajtohej. Ai insistonte që unë duhej të isha më i vendosur në kuptimin e caktimit të rasteve gjyqtarëve që do të dënonin. Ai në mënyrë specifike më udhëzoi që të mos caktojë gjyqtarë, të cilët më herët i kishin shfajësuar të pandehurit, në rastet e profilit të lartë. Sipas mendimit të tij këtyre gjyqtarëve “*nuk mund t’u besohet?*”. Unë vazhdimisht ia kam përkujtuar që nuk do të ishte me vend dhe që funksiononte sistemi për ndarejn rastësore të lëndëve.

62. Shefi i misionit e bëri të qartë që ai parapëlqente gjyqtarët nga vendet e Evropës Lindore sepse, sipas mendimit të tij, ata ishin më të dëgjueshëm dhe bënë atë që “*pritej?*” prej tyre. Ishte e mirënjohur që gjyqtarët nga Polonia, Bullgaria dhe Rumania fitonin shumë më shumë në EULEX dhe në misionet e tjera të BE-së se sa që do të fitonin në rolin e tyre gjyqësor në vendin e tyre. Udhëheqja e misionit EULEX besonte që kjo i bënte ata më ‘të dëgjueshëm’.
63. Caktimi i gjyqtarëve në raste u bë betejë e rregullt me shefin e misionit. Kur futej në listë për gjykim ndonjë rast i profilit të lartë, nga unë kërkohej që për atë rast ta caktoja një gjyqtar ‘që kishte mirëkuptim’. Më vonë shefi i misionit EULEX Meucci insistoi që të bëheshin ndryshime në sistemin për caktimin e rasteve, në mënyrë që t’i jipeshin më shumë kompetenca kryetarit të gjyqtarëve të EULEX-it për ri-caktimin e rasteve. Ai më tha që priste nga unë t’ua caktoja rastet gjyqtarëve në të cilët misioni mund të kishte besim që do të dënonin.
64. Në disa raste shefi i misionit të EULEX – it më sugjeroi që, në rastet kur provat e prokurorisë ishin të dobëta, prapë do të mund të sigurohej dënimi duke e caktuar një gjyqtar që “*e kuptonte përse ishte këtu?*”. Me fjalë të tjera, duke e caktuar një gjyqtar i cili prapë do të dënonte pavarësisht provave.
65. Zëvendës shefi i misionit, Bernd Thran, po ashtu rregullisht i kritikonte gjyqtarët e EULEX-it. Ai nuk e kuptonte konceptin e pavarësisë gjyqësore, duke pyetur shpesh “*çka nuk shkoi mirë kësaj radhe?*” pasi që një gjyqtar i EULEX-it e kishte shfajësuar të pandehurin ose kishte nxjerrë vendim me të cilin ky nuk ishte pajtuar. Në njërin prej rasteve të tilla, e

pyeta “*a e keni lexuar vendimin e gjyqtarit*”. Duke u përgjigjur Bernd Thran tha “*Nuk kam nevojë ta lexojë atë. E di që është gabim*!”. Shfajësimi shihej si dështim. EULEX-i dhe EEAS e matnin suksesin me numrin e dënimeve.

66. Gjyqtarët e EULEX-it madje akuzoheshin për korrupsion nëse merrnin vendime që nuk i pëlqenin udhëheqjes së misionit. Gjyqtaret Katrien Witteman dhe Anna Adamska u akuzuan për korrupsion nga një menaxher i lartë si përgjigje ndaj vendimeve që kishin marrë ato. Nuk kishte bazë për pretendime. Pasi që dhashë dorëheqje nga EULEX-i, më kontaktoi një gazetar i pavarur, i cili dëshironte përgjigjen time lidhur me pretendimet e bëra nga prokurori i EULEX-it, Danilo Ceccareli, që unë kisha marrë rryshfet për ta “mbytur” një rast. Përsëri, nuk kishte bazë për këtë pretendim që ishte plotësisht i rremë. Megjithatë, kjo ishte kultura brenda misionit. Nga gjyqtarët pritej të dënonin. Kur nuk e bënë një gjë të tillë, ata kritikoheshin nga udhëheqja e misionit dhe nganjëherë akuzoheshin për korrupsion.
67. Shumices se Gjyqtareve vendor te Kosoves nuk iu besohej brenda Misionit. Ekzistonte nje perceptim i perhapur brenda Misionit se nese gjyqtaret vendor kishin qasje ne informata te ndjeshme ata do te shpalosnin n je informate te tille. Gjithashtu ekzistonte ndjenja se gjyqtaret vendor nuk do ta shpallnin fajtor ndonje ushtar te UCK-se apo ndonje te pandehur te profilit te larte me origjine Shqiptare.. Perberja e Paneleve shqyrtohej me kujdes per te siguruar qe, ne rastet ishin te rendesishme per Misionin, te kishte shumice te Gjyqtareve te EULEX-it dhe atyre gjyqtarev do tu besohej shpallja e fajesise.
68. Gjyqtarët e EULEX-it nuk ishin të vetmit ndaj të cilëve bëhej presion. Prokurorët e EULEX-it po ashtu ishin nën presion t’i ndiqnin rastet kundër të pandehurve të profilit të lartë – madje edhe kur nuk kishte prova të mjaftueshme për ta siguruar dënimin.
69. Prokuroret e EULEX-it rrallë here ishin te pavarur ne vendimarrjen e tyre. Udhezimet rreth asaj se cilat me cilat lende te procedohej me ndjekje penale dhe si te behej nje gje e tille jane marre neper takime te managementit. T enjeften menyre se si Managementi i Misionit i kishte “preferuar” gjyqtaret ata “preferonin” edhe prokuroret.
70. Pas themelimit te Dhomave te Vecanta te Kosoves une kam filluar te degjoje thashetheme qe qarkullonin te Managementi i Larte se “Brukseli” nuk ishte i kenqaur me Prokurorin e Dhomave te Vecanta, David Schwendeman, sepse zyra e tij nuk kishin hapur aktakuza. Insinuata ne ate kohe ishte se zyre prokurorit kishte menduar se deshmia kunder disa

anetareve te profilit te larte te UCK-se ishte e dobet,, ne rastin me te mire. Une isha informuar se diskutimet vazhdonin ne Bruksel me pikepamjet se Z. Schmendenman te zevendesohet nga nje person tjetet qe do mund ti “besohet”.

71. Kishte shumë raste të sjelljes së keqe në të cilat përfshiheshin gjyqtarët e EULEX-it dhe stafi i lartë.
72. Në tetor 2014 m'u afrua një gjyqtar i EULEX-it në Mitrovicë. Ai më tregoi për sjellje të keqe në të cilën ishin të përfshirë gjyqtarët e EULEX-it në Mitrovicë. Këtu përfshihej një gjyqtare e EULEX-it, e cila e kishte kryer një proces të identifikimit në zyrën e saj, në mes të gjykimit, me të pandehurin dhe avokatin mbrojtës por pa praninë e prokurorit. Në rastin e dytë, në mes të një gjykimi për përdhunim, kryetari i trupit gjykues të EULEX-it e ka vizituar viktimën në shtëpinë e saj në mënyrë që ta dëgjojë dëshminë e saj. As avokati mbrojtës as prokurori nuk kanë qenë të pranishëm.
73. Në një rast krimi të profilit të lartë, një dëshmitar i mbrojtur ishte zhvendosur përkohësisht në një shtet anëtar të BE-së. Dëshmitari kishte histori të sëmundjes psikiatrike. Edhe pse e dinte që dëshmitari ishte i cenueshëm, EULEX-i ndërmori shumë pak, ose hiç, masa për shëndetin e tij mendor. Shëndeti i tij mendor gradualisht u përkeqësua. EULEX-i nuk e informoi shtetin anëtar të BE-së që e kishte zhvendosur një dëshmitar të mbrojtur në juridiksionin e tyre. Në të vërtetë, autoritetet e shtetit anëtar të BE-së e zbuluan që në juridiksionin e tyre ishte një dëshmitar i mbrojtur vetëm kur ai u gjet i vdekur.
74. Shumë dëshmitarë të prokurorisë, disa prej të cilëve ishin nën masa të mbrojtjes, pohuan që EULEX-i iu kishte premtuar atyre dhe familjeve të tyre që do të zhvendoseshin në një shtet evropian nëse ofronin prova për prokurorinë. Në disa raste, këto raporte keqpërdorshin. U bë ftesë për falsifikimin e provave dhe për gënjeshtër. Në disa raste premtimet dolën të jenë të pavlefshme. As nuk mund ta them numrin e saktë të të gjithë dëshmitarëve që dolën para meje dhe pohuan që prokurorët e EULEX-it ua kishin premtuar botën. Stimulimet tërheqëse që ishin në ofertë për dëshmitarët, pashmangshëm do të rezultonin me gënjeshtër dhe dëshmitarëve në mënyrë që ta siguronin një jetë më të mirë për veten e tyre dhe për familjet e tyre.
75. Në te ashtuquajuren rasti Kleçka, dëshmitë të cilat i kishte dhënë dëshmitari i mbrojtur nuk u kundërshtuan vetëm nga dëshmitë e tij por edhe nga provat e tjera, përfshirë provat mjeko-ligjore. Bashkëshortja e tij, e cila dha dëshmi para gjykatës, pohoi që prokurorët e

EULEX-it i kishin premtuar familjes së tyre “parajsën” si shkëmbim për dëshminë e tij, por nuk i kishin realizuar ato premtime.

76. Kishte edhe tregime të tjera kur dëshmitarët e mbrojtur u ekspozuan. Në një rast, një dëshmitar që jepte dëshmi prej një vendi të largët ishte informuar nga prokurori i EULEX-it që ata e kishin dorëzuar në gjykatë një kërkesë për masa mbrojtëse dhe, në bazë të asaj që iu kishte thënë prokurori i EULEX-it, ai kishte menduar që ekрани do të ishte i mjegulluar dhe identiteti i tyre do të fshihej. Dëshmitari u tmerrua kur e zbuloi që gjykata – dhe të pandehurit – mund t’ia shihnin fytyrën. Dëshmitari ishte shumë i traumatizuar për ta vazhduar dhënien e dëshmisë. . Në një rast tjetër të profilit të lartë prokurori i EULEX-it nuk e redaktoi emrin e një dëshmitari anonim nga deklarata të cilën ia dha avokatit mbrojtës. Prandaj të pandehurit e zbuluan emrin e dëshmitarit të mbrojtur. Në një rast tjetër, kryetari i trupit gjykues të EULEX-it i lexoi me zë në gjykim të hapur emrat e dëshmitarëve të mbrojtur, duke mos e kuptuar që ata ishin dëshmitarë të mbrojtur.

77. Për mua ishte shqetësim i madh fakti që EEAS dhe EULEX nuk kishin bërë ndonjë plan për sigurinë e dëshmitarëve të mbrojtur kur EULEX-i të hiqte dorë nga mandati ekzekutiv. Dosjet me emrat e dëshmitarëve të mbrojtur thjesht do të ktheheshin në regjistrat e gjykatës. Unë e diskutova këtë çështje me disa prokurorë të EULEX-it. U befasova nga reagimi i tyre. Thënë thjesht: shumica prej tyre nuk brengoseshin. Disa gjyqtarë të EULEX-it ishin më të kuptueshëm – por jo të gjithë. Kur e ngrita këtë çështje me zyrtarët e lartë në Bruksel, përgjigja e tyre ishte në masë të madhe në këtë kuptim ‘nuk mund të bëjmë asgjë, sidoqoftë, dëshmitarët e kanë realizuar qëllimin e tyre’. E kam ngritur këtë çështje shumë herë me udhëheqjen e lartë. Këtë shqetësim e kanë ndarë edhe disa të tjerë, përfshirë udhëheqësen e Divizionit Ekzekutiv, Jaroslava Novotna, ndërsa të tjerët kanë treguar shumë pak interesim të vërtetë. Shefi i misionit madje sugjeroi që dokumentet në të cilat gjendej identiteti i dëshmitarëve të mbrojtur duhet të shkatërroheshin. Ia sqarova që dokumentet me emrat e dëshmitarëve të mbrojtur ishin pjesë e dosjes gjyqësore dhe nuk mund të shkatërroheshin.

78. Përveç çështjeve lidhur me sigurinë e dëshmitarëve të mbrojtur, unë isha po ashtu i shqetësuar lidhur me kredibilitetin e disa dëshmitarëve. Të njëjtat shqetësime i kishte edhe shefi i atëhershëm i Zyrës së Inteligjencës Kriminale të EULEX-it, Michael Rawlinson. Ai ma dha një raport të redaktar të EUOCI. Raporti iu referohej dëshmitarëve që ishin

kërcënuar ose stimuluar të jipnin dëshmi të rreme në rastet e krimeve të luftës. Të pandehurit në ato raste ishin politikanë të profilit të lartë.

79. Michael Rawlinson më tha që ai kishte zbuluar keqpërdorim të përhapur dhe sistematik të dëshmitarëve nga hetuesit e EULEX-it. Disa dëshmitarë me të cilën Michael kishte folur, i kishin thënë atij që iu kishin dhënë deklaratat hetueseve ndërkombëtarë lidhur me krimet e pretenduara të luftës. Nga ata dëshmitarë më pas ishte kërkuar t'i nënshkruajnë deklaratat që ishin ndryshuar dhe që implikonin rrejshëm të akuzuarit. Në rastet e tjera, dukej që dëshmitari ose e kishte trilluar ose e kishte zmadhuar përfshirjen e një individi të caktuar në këmbim për premtimet e zhvendosjes ndërkombëtare të anëtarëve të familjes së dëshmitarit.

80. Michael Rawlinson iu referua në mënyrë specifike katër politikanëve të profilit të lartë. Ai tha që kishte folur me disa dëshmitarë të cilët kishin qenë nën presion të konsiderueshëm për të dhënë deklaratat të rreme. Dëshmitarëve iu ishin ofruar stimulime domethënëse financiare, përfshirë zhvendosjet ndërkombëtare me përfitime në të cilat përfshihej strehimi, sigurimi social dhe ndihma në gjetjen e një pune që paguhej mirë, Nëse i nënshkruanin deklaratat të cilat ata e dinin që janë të rreme. Ai tha që kishte marrë deklaratat nga disa dëshmitarë dhe kishte planifikuar të intervistonte dëshmitarë të tjerë. Ky ishte qarte një hetim shumë i ndjeshëm dhe Michael më tha se ishte duke e bërë "jashtë rrjetit". Kur përdori një shprehje të tillë unë mendova se hetimin ai e kryente me inicizative të vetendhe se këto nuk e kishte raportuar tek zingjiri më i lartë komandues. Nuk kishte kaluar shumë kohe pas diskutimit me Michael Rawlinson dhe ai ishte suspenduar. E dija që do të kishte hetim lidhur me suspendimin e Michael-it. Megjithatë, shefi i misionit e bëri shumë të qartë që, pavarësisht nga rezultati i hetimit, ai nuk do të pranonte që Michael të kthehej në mision. Do ta adresojë 'afërën' e Michael Rawlinson në vijim.

81. Edhe unë po ashtu u brengosa për komunikimet ex-parte ndërmjet gjyqtarëve të EULEX-it dhe prokurorëve në mes të gjyqimit. Një gjyqtar i EULEX-it madje u ndje i detyruara të ma dërgoj një email me anë të të cilit më informonte për komunikimin e gjyqtarëve të EULEX-it me prokurorët e EULEX-it në mes të gjyqimit. Edhe vetë kisha qenë dëshmitar i kësaj. Në të vërtetë, disa herë më ishin afruar prokurorët e EULEX-it me kërkesën që ta caktoj një gjyqtar të caktuar të EULEX-it në rastet e tyre. Një prokuror i EULEX-it më tha që gjyqtari të cilin e kishte kërkuar ai që ta caktojta unë "do ta kuptonte rastin". Këta

ishin gjyqtarët të cilët ata i konsideronin të jenë dashamirës ndaj rastit të tyre ose gjyqtarët që ata e dinin se do të jepnin dënime. Shumë gjyqtarë të EULEX-it fitonin në mënyrë të konsiderueshme më shumë duke punuar për EULEX-in se që kishin fituar në gjykatat e vendeve të tyre. Disa ishin të përgatitur të bënin çmos për ta siguruar vazhdimin e luksit.

82. Në shumë raste, gjyqtarët e EULEX-it ishin në komunikim të rregullt ex-parte me prokurorët e EULEX-it. Në rastet e paraburgimit dhe në rastet e profilin të lartë vendimet shpesh janë marrë ndërmjet gjyqtarëve të EULEX-it, prokurorëve të EULEX-it dhe udhëheqjes së misionit edhe para se të mbahej seanca. Unë madje kam marrë pjesë edhe në disa ankesa në Gjykatën Supreme në fillim të të cilave kolegu im gjyqtar i EULEX-it më pat thënë që ai e kishte “diskutuar” rastin me prokurorin. Gjyqtari vendas gjithmonë përjashtoj nga këto biseda.

83. Kam marrë pjesë në njoftimet javore me shefin e misionit të EULEX-it, shefin e Divizionit Ekzekutiv dhe Kryeprokurorin e EULEX-it. Gjatë këtyre takimeve diskutoheshin rastet e EULEX-it. Shefi i misionit i shfrytëzonte këto takime për t'i udhëzuar prokurorët e EULEX-it lidhur me prioritetet e misionit dhe cilat lende të ndjekeshin penalisht. .

84. Po ashtu u bë e qartë që ekzistonte një dialog i vazhdueshëm ndërmjet Brukselit, shefit të misionit dhe prokurorëve të EULEX-it lidhur me rastet të cilat duhet të ndiqeshin.

85. Në fillim të qershorit 2014, m'u afrua një gjyqtar i EULEX-it i cili ishte i shqetësuar që e kisha caktuar gjyqtaren Anna Adamska në trupin gjykues në një rast të profilin të lartë të njohur si 'Drenica'. Ky rast u ishte caktuar gjyqtarëve të EULEX-it në Mitrovicë. Gjyqtari më pyeti përse gjyqtarja Adamska, gjyqtare e Njësisë Mobile në Prishtinë, ishte caktuar në atë rast. I thash që nuk e kisha caktuar unë gjyqtaren Adamska, por që do të pyesja për këtë. Pastaj fola me gjyqtaren Adamska. Ajo e vërtetoi që ishte caktuar në këtë rast si anëtare e trupit gjykues dhe ma dërgoi shkëmbimin e emailave lidhur me atë detyrë.

86. Ishte një shkëmbim interesant i emailave. Të enjten me 29 maj 2014, në 11:37, gjyqtari Sielicki i shkruajti gjyqtares Katja Dominik, e cila në atë kohë ishte përgjegjëse për caktimin e gjyqtarëve të njësisë së gjyqtarëve të Mitrovicës dhe tha: *“Në lidhje me përgatitjet për gjykimin Drenica 2 (9 të pandehur), ju lus me mirësi që ta keni parasysh t'i kërkonti kryetarit të asamblesë së [sic] gjyqtarëve të EULEX-it ta caktojë një gjyqtar nga Njësia Mobile që të jetë anëtar i trupit gjykues në këtë rast.”* Dy minuta pasi që e mori atë email, gjyqtarja Dominik ia dërgoi një email

kryetarit në detyrë të asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it, gjyqtarit Sprenger, ku ajo e aprovoi atë kërkesë. Pesë minuta pas pranimit të emailit të gjyqtares Dominik, gjyqtari Sprenger e nxori një udhëzim për këshilltarin e tij ligjor që ta hartojë një vendim për emërimin e gjyqtares Adamska në trupin gjykues.

87. Me 29 maj 2014 isha gjyqtar i lartë në Njësinë Mobile përgjegjës për caktimin e gjyqtarëve në raste, duke e ndjekur sistemin e rastësor për ndarjen e rasteve. Gjyqtarja Adamska ishte gjyqtare në Njësinë Mobile. Unë nuk u konsultova dhe nuk më pyetën cili gjyqtar e kishte radhën t'i caktohej një rast sipas regjistrit rastësor për ndarjen e rasteve. Unë nuk u konsultova para se gjyqtarja Adamska të caktohej në atë rast. Është interesant, edhe pse unë isha gjyqtari përgjegjës për caktimin e gjyqtarëve të Njesisë Mobile, mua madje as nuk më kishin kopjuar në shkëmbimin e emailave ndërmjet Dominik-it, Sielicki-t dhe Sprenger-it. Nuk kishte kohë të mjaftueshme ndërmjet kohës kur gjyqtari Sprenger e mori atë email dhe dhënies së përgjigjes në atë kërkesë dy minuta më vonë për të pyetur në mënyrë që ta vërtetonte nëse gjyqtarja Adamska ishte në dispozicion ose për të më pyetur mua çfarë angazhimesh tjera kishte ajo në Njësinë Mobile. Duket sheshit që kishte pasur tjetër komunikim ndërmjet tyre dhe shkëmbimi i emailave ishte dezajnuar për ta lënë përshtypjen e rregullsise dhe që ishte respektuar procedura e duhur.

88. Unë kam folur me gjyqtarin Sprenger dhe e kam pyetur përse nuk isha konsultuar. Ai tha që kishte menduar që unë kisha njohuri për caktimin e gjyqtares Adamska në atë rast. I thashë që nuk kisha. Kërkova që ta anulonte emërimin e tij. Ai refuzoi. Ai tha që 'misioni' ishte "i kënaqur" me trupin gjykues sepse gjyqtari Sielicki kishte reputacion në mision që i dënonte të pandehurit të cilët, në mënyrë specifike, ishin shënjestruar nga misioni. Gjyqtarai Sprenger tha që për shkak të lidhjes ndërmjete gjyqtarëve Sielicki dhe Adamska, prania e gjyqtares Adamska në trupin gjykues "do ta sillte rezultatin e duhur."

[REDACTED]

[REDACTED]

[REDACTED]

[REDACTED]

[REDACTED]

[REDACTED]

[REDACTED]

[REDACTED]

[REDACTED]

[REDACTED]

[REDACTED]

93. Më 2015, me kërkesën e avokatit mbrojtës Gregor Guy Smith për hetimin e mënyrës sipas së cilës ishte formuar trupi gjykues në rastin Drenica, unë e informova atë me shkrim që do të ishte e papërshtatshme ta bëja një gjë të tillë sepse parashikoja që mund të ftohesha si dëshmitar. Në atë fazë e kisha të qartë që isha dëshmitar potencial për shkak të faktit të çështjeve lidhur me mënyrën sipas së cilës ishte formuar trupi gjykues dhe të lidhjes ndërmjet dy gjyqtarëve të EULEX-it në trup gjykues.

94. Gjatë fazave të hershme të gjykimit hëngra darkë me gjyqtarët Seilicki dhe Adamska në një restorant në periferi të Prishtinës. Gjatë takimit gjyqtari Sielicki i përshkruajti të pandehurit në Drenicë si “kafshë” dhe shqiptarët si “të lindur”. Ai tha që po t’i dënonte të pandehurit ai do të mund të punonte kudo brenda sistemit të BE-së. Gjyqtarja Adamska pastaj u emërua në një pozitë të lartë në një projekt të financuar nga BE-ja në Ukrainë dhe gjyqtari Sielicki po ashtu u emërua në një rol konsulence në projektin e njëjtë.

95. Më 2016 kërkoja përsëri nga udhëheqja e misionit ta fillonte një hetim lidhur me përzgjedhjen e trupit gjykues në Drenicë. Misioni nuk pranoi të ndërmarrë ndonjë veprim.

96. Më 2017, Gjykata Supreme e Kosovës, pjesa më e madhe gjyqtarë të EULEX-it, e refuzuan kërkesën e avokatit mbrojtës që ta dëgjonin dëshminë time lidhur me përbërjen e trupit gjykues në atë rast. Me 11 qershor 2018, Gjykata Kushtetuese e Kosovës konstatoi që trupi gjykues i Gjykatës Supreme e kishte shkelur nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut sepse nuk e kishin dëgjuar dëshminë time. Ajo kishte konstatuar që trupi gjykues i Gjykatës Supreme i kishte shkelur të drejtat e të pandehurve për gjykim të drejtë. Isha i tronditur por jo i befasuar. Këtu e kishim një mision të BE-së për sundimin e ligjit i cili nuk i mbronte parimet që ishin *raison d'être* (*vërejtje e përkthyesit: arsyeja më e rëndësishme për ekzistimin*) e misionit.
97. Ishte shumë e qartë që gjyqtarët e EULEX-it dëshironin ta shmangnin turpërimin e mundshëm meqë unë do ta ekspozoja në gjykatë të hapur atë që, në të vërtetë, kishte ndodhur në prapaskenë. Ruajtja e reputacionit dhe e integritetit të misionit u bë prioritet.
98. Kleçka dhe Drenica nuk ishin rastet e vetme të ndjeshme të krimeve të luftës në të cilat udhëheqja e misionit EULEX ishte përpjekur të ndërhynte në rastet penale në të cilat kryesues ishin gjyqtarët e EULEX-it.
99. Më 2017 kishte përpjekje nga udhëheqja e misionit për ta çuar përpara gjykimin e Oliver Ivanoviçit për arsye haptazi politike. Gjatë njërit prej takimeve të mia të rregullta me shefen e misionit EULEX, në të cilin morën pjesë Katja Dominik, atëherë udhëheqëse e Divizionit Ekzekutiv, shefja e misionit më shtyri të ndërhyjë në orarin e caktuar të gjykimeve në mënyrë që gjykimi i Ivanoviçit t'i kalonte rastet e tjera. E mora me mend arsyen. Shefja e misionit ishte e qartë që nuk dëshironte që Ivanoviçi të merrte pjesë në zgjedhjet ardhshme. Shefja e misionit thotë që “ishte e qartë” që Ivanoviçi ishte fajtor. E pyeta nëse i kishte parë provat, me çrast ajo thotë “Katja (Dominik) ka folur me gjyqtarët”. I thashë Katjas që kjo ishte e papërshtatshme që ajo, si udhëheqëse e Divizionit Ekzekutiv, të komunikonte me gjyqtarët dhe që çdo komunikim me gjyqtarët duhet të kalonte përmes meje. Më pastaj, më 7 korrik 2017, e mora një email nga Katja Dominik në të cilin, duke iu referuar rastit Ivanoviç, ajo tha “... *Po më pyesin nëse gjykimi do të përfundojë deri në tetor kur ka mundësi të kemi zgjedhje lokale. A mundsh të lutem të shikosh se çka po ndodhë?*” Ne u takuam disa ditë më vonë kur Katja Dominik u përpoq të më bëjë presion që ta lëviz Ivanoviçin në krye të listës. Unë refuzova. Në përgjigjen e saj, ajo tha “Brukseli do të jetë shumë i pakënaqur.” Pse ishte një misioni i sundimit të ligjit i BE-së aq i shqetësuar lidhur me zgjedhjet e ardhshme komunale?

100. Vazhdimisht e kam gjetur veten në pozitë të ‘absorbuesit’ ndërmjet stafit të lartë të EEAS në Bruksel, udhëheqjes së misionit dhe gjyqtarëve të EULEX-it. Po ashtu isha në dijeni që Katja Dominik ishte në komunikim të rregullt me gjyqtarët e EULEX-it dhe që i diksutonte rastet.

101. Kishte shumë çështje që përfshinin profesionalizmin e gjyqtarëve të EULEX-it, të cilat i kisha vënë re. Ato silleshin prej marrjes së prostitutave nga ana e gjyqtarëve të EULEX-it deri te konfrontimet verbale të gjyqtarëve të EULEX-it me gjyqtarët vendas, në të cilat përfshiheshin pretendimet për sulm, dhe deri te mos-pjesëmarrja e gjyqtarëve të EULEX-it në gjykatë. Unë e fillova një sistem për monitorimin e përmbushjes së gjyqtarëve të EULEX-it, i cili ishte jopopullor në mesin e shumë gjyqtarëve të EULEX-it. Një gjyqtar i EULEX-it më tha që ishte punë e tija nëse vinte në gjykatë apo jo dhe që kjo ishte ‘pavarësi gjyqësore’. Analiza ime e përmbushjes së gjyqtarëve të EULEX-it e zbuloi që, mesatarisht, ata ishin në gjykatë tri ditë në muaj dhe e kryenin ‘funksionin’ gjyqësor më pak se pesë ditë në muaj.

101. Çështje posaçërisht shqetësuese për mua ishte që trupat gjykues në Mitrovicë përbëheshin vetëm nga gjyqtarët e EULEX-it. Kjo ishte në kundërshtim me ligjin që iu referohej trupave gjykues të përbërë nga “shumica” gjyqtarë të EULEX-it. Ligjshmëria e të gjitha vendimeve të paneleve veç të EULEX-it në Mitrovicë është shumë e diskutueshme.

102. Po ashtu kishte çështje të cilat përfshinin gjyqtarët të EULEX-it që transferoheshin në gjykata të larta pa dijeninë dhe aprovimin e Keshillit Gjyqësor të Kosovës dhe pa emërim formal nga Presidenti. Shumë vendime janë nxjerrë nga gjyqtarët e EULEX-it të cilët nuk ishin emëruar në mënyrë të ligjshme në gjykatat ku ishin kryesues, përfshirë Gjykatën e Apelit. Të pandehurit ishin dënuar nga gjyqtarët e EULEX-it, të cilët nuk kishin autoritet të ligjshëm t’i shqyrtonin ato lëndë. Kur u bëra kryetar i gjyqtarëve të EULEX-it i udhëzoja këta gjyqtarë ta ndalnin punën dhe urdhërova rishikimin e atyre lëndëve.

[REDACTED]

[REDACTED]

[REDACTED]

[REDACTED]

[REDACTED]

104. Gjatë tërë hetimit, z. Cecarelli kishte komunikim të rregullt me shefin e misionit të EULEX-it.

■ Në qershor 2015, kasaforta në zyrën e Michael Rawlinson ishte hapur me forcë. Në mes të gjërave të tjera, në të gjendeshin dëshmi përfshirë transkriptete e audio incizimeve që dukej se tregonin që pjesëtarët e stafit të EULEX-it ishin të përfshirë në kryerjen e veprave penale. ■

■
■
■
■
■

106. Pasi që u zbulua përmbajtja e kasafortës, mua më informoi shefi i misionit EULEX që ishin udhëzuar nga “Brukseli” ta ndalim punën tonë menjëherë. Nuk morëm sqarime. Më thanë që stafi i lartë i EEAS do të më intervistonin lidhur me atë që kishim zbuluar. Më pastaj u intervistova lidhur me këto ngjarje nga një bord hetues i krijuar nga EEAS. Njëri prej hetuesve ishte Chris Starmans, personi i njëjtë i cili më vonë do t’i hetonte pretendimet e rreme kundër meje. Njëra prej pyetjeve, të cilën ma bënë hetuesit, ishte nëse mendoja që ishte e dyshimtë që, si anëtar i lartë i bordit të hetimeve, nuk e kisha kryesuar hetimin por që atë e kishte bërë një prokuror italian që i kishte raportuar një shefi të misionit italian. Konkluzioni ishte i qartë. Iu referova dokumenteve që ishin gjetur në kasafortë, në veçanti ‘Kalit të Trojës’ që shkaktoi shqetësime serioze lidhur me hetimet për krimet e luftës dhe paanësinë e procedurës. Më thanë të mos flas. Madje edhe më paralajmëruan që mund të ndiqesha penalisht nëse do ta zbuloja ekzistimin e saj ndonjëherë.

■

108. Këto janë çështje të cilat mendoj që janë relevante për hetimin tuaj. Natyrisht, do të përpiqem të përgjigjem plotësisht në çfarëdo pyetjeje të cilat m’i bën Parlamenti i Kosovës.

109. Nëse UE me të vertete e ka mbështetur sundimin e ligjit ata do të dëshironin të marrin pjesë në hetimin tuaj dhe të përgjigjen në pyetjeve të cilat, pas degjimit të dëshmise time,

sigurisht se ju do te keni per ata. Une parashikoj se UE nuk do ta bejne kete per nje arsye shume te thjeshte: Se ata nuk mund te kene ne kontrolle rezukltatit.

110. Në lidhje me çështjet të cilave u referohem këtu, unë do t'i paraqes Parlamentit të Kosovës dokumente dhe prova të tjera në mbështetje.

Datuar ne ditën 3 Qershor 2021

.....
Malcolm Simmons

